



Prishtinë: 24.09.2018  
Kodi i ZRRE-së: V\_1042\_2018

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_1844\_08\_18**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **04.09.2018**.

në seancën e mbajtur më datë **24.09.2018**, nxori këtë:

### V E N D I M

- I REFUZHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin I. B. nga fshati Talinoc i Muhaxherëve, Ferizaj me shifër të konsumatorit: DFE - 9013170, si e pa bazuar.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK\_V\_1844\_08\_18 i datës 14.08.2018.

### A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 04.09.2018 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë për këto shkaqe: Përfaqësuesi i KESCO-së, në ankesë ka theksuar se korrigjimi plotësues i KESCO-s është real dhe bazohet në rezultatet e qendrës së kalibrimit. Në ankesë është theksuar se konstatimi i ZRRE/DMK se konsumatori ka rënie të shpenzimit nuk mund të merret e saktë pasi që konsumatori nuk ka shpenzim konstant, dhe se nëse merret parasysh shpenzimi i periudhës 02/2015 deri 01/2016 shihet se ka rritje të shpenzimit. Në ankesë gjithashtu është theksuar se sipas konstatimeve të bëra nga organi i shkallës së parë se në shpenzimet në tarifën e ulët janë në rregull dhe se duhet të korrigjohet vetëm tarifa e lartë atëherë korrigjimi do të duhej të bëhej edhe para periudhës 05/2015, si dhe korrigjimi në fjalë bazohet në nenin 4.11.1 të Kodit të matjes të OSSH. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK\_V\_1844\_08\_18 i datës 14.08.2018 për konsumatorin I. B. me shifër DFE – 9013170.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 24.9.2018 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.



Sa i përket pikës së kundërshtimit se KESCO se korrigjimi plotësues është real dhe bazohet në rezultatet e qendrës së kalibrimit, Bordi i ZRRE-së thekson se gjatë analizës së bërë shkresave të lëndës ka vërejtur se korrigjimi i KESCO nr.43358DFE-9013170 dhe nr.43359DFE-9013170 në vlerë **2,025.03€** është i bazuar vetëm në procesverbalin e kalibrimit dhe në asnjë analizë tjetër të shkresave tjera. Bordi i ZRRE-së gjatë analizimit të shkresave të lëndës ka vërejtur se konsumatori në fjalë me datë 17.12.2013 ka bërë kërkesë zyrtare në KEDS për ndërrim njehsori për shkak të dyshimit në çrregullimin e matjes së njehsorit elektrik nr.4692300, mirëpo që ndërrimi i njehsorit elektrik është bërë tek me datë 09.01.2016 dhe në procesverbal është evidentuar gjendja e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr.4692300 prej TL=040603 kWh dhe TU=160790 kWh, si dhe kanë evidentuar që njehsorit elektrik disku i rrotullohet, por që numërori nuk bën regjistrimin e energjisë së shpenzuar. Punëtorët e autorizuar të KEDS-it po me atë datë kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr.4692300 me gjendje TL=040603 kWh dhe TU=160790 kWh, si dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 64647475 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh. Bordi i ZRRE-së gjatë analizimit të këtyre shkresave ka vërejtur se në asnjërin procesverbal nuk është evidentuar që ndërrimi i njehsorit elektrik është bërë me kërkesë të konsumatorit.

Bordi i ZRRE-së gjithashtu ka analizuar edhe procesverbalin e kalibrimit të bërë me datë 02.02.2016 ku është bërë shqyrtimi i saktësisë së matjes të njehsorit elektrik nr.4692300 dhe ku është konstatuar se: njehsori elektrik nuk është në rregull, njehsori elektrik ka vulat (bllombat) shtetërore, njehsori elektrik releun e ka në prishje, nga ana e jashtme njehsori dëmtime nuk ka, si dhe kanë konstatuar se gabimi në matje në tarifën e lartë është **-0.15%**. Po ashtu në procesverbal është evidentuar që në momentin kur njehsori elektrik kalon në T1 nuk regjistron energji elektrike, ndërsa disku rrotullohet. Po ashtu me datë 29.03.2016 punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr.4692300, ku kanë konstatuar se: njehsori elektrik vulat i ka në rregull, nga ana e jashtme njehsori dëmtime nuk ka, si dhe në brendi të njehsorit komisioni nuk ka vërejtur ndonjë parregullsi.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO se konstatimi i ZRRE/DMK se konsumatori ka rënie të shpenzimit nuk mund të merret e saktë, Bordi i ZRRE-së thekson se gjatë analizës së rrjedhës së energjisë elektrike për periudhat kontestuese me njehsorin e vjetër elektrik-kontestues nr.4692300 dhe njehsorin e ri elektrik nr.64647475 për periudha të njëjta kohore, konsumatori ka ndryshim të shpenzimeve të energjisë elektrike. Nga analiza e bërë shpenzimit të energjisë elektrike aktive vërehet se me njehsorin elektrik nr.4692300 prej periudhës 01/2013 deri në periudhën 12/2013 mesatarja mujore e shpenzimit është 1302 kWh/muaj, prej periudhës 01/2014 deri në periudhën 12/2014 mesatarja mujore e shpenzimit është 546 kWh/muaj, si dhe prej periudhës 01/2015 deri në periudhën 12/2015 mesatarja mujore e shpenzimit është 676 kWh/muaj, kurse me njehsorin e ri elektrik nr. 64647475 prej periudhës 02/2016 deri në periudhën 12/2016 mesatarja mujore e shpenzimit është 1,224 kWh/muaj, prej periudhës 01/2017 deri në periudhën 12/2017 mesatarja mujore e shpenzimit është 1,609 kWh/muaj, si dhe prej periudhës 01/2018 deri në periudhën 08/2018 mesatarja mujore e shpenzimit është 1,753 kWh/muaj. Bordi i ZRRE ka analizuar shpenzimin e energjisë elektrike të konsumatorit dhe ka vërejtur se shpenzimi i energjisë elektrike nga periudha 05/2015 e deri më 01/2016 ka rënie të shpenzimit të energjisë elektrike me shpenzimin e energjisë elektrike para dhe pas kësaj periudhe.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO se nëse do të duhej të korrigohej vetëm tarifa e lartë atëherë korrigjimi do të duhej të bëhej edhe para periudhës 05/2015, Bordi i ZRRE-së thekson se gjatë analizës së bërë korrigjimit të bërë nga KESCO është evidentuar se korrigjimi plotësues është i gabuar, pasi që faturimi i bërë nuk përputhet me mesataren e shpenzimeve të marra për periudhën 02/03/2016 dhe 04/2016 pasi që ka ndryshime për periudha të ndryshme, si dhe korrigjimi i tillë është bazuar në nenin 32 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji. Bordi i ZRRE-së thekson se kjo dispozitë ligjore ka të bëjë vetëm me shfrytëzimin e paautorizuar të energjisë



elektrike, e që në rastin e konsumatorit nuk kemi të bëjmë me shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike. Bordi i ZRRE-së thekson se laboratorit i kalibrimit ka vërtetuar se njehsori elektrik nuk ka qenë i dëmtuar në çfarëdo forme, përveç mos matjes në tarifën e lartë me çka edhe vërtetohet se nuk ka keqpërdorim të energjisë elektrike, por që kjo ka ndodhur për shkak të prishjes së releut tarifor dhe se të gjitha korrigjimet mund të bëhen duke u bazuar në Kodin e matjes së OSSH-së, andaj duke u bazuar në gabimet e bëra në kalkulim, rrjedhën e energjisë elektrike ku konsumatori ka nga periudha 05/2015 e deri 01/2016 ka rënie të shpenzimit me njehsorin nr.4692300 krahasuar me njehsorin e ri elektrik nr. 64647475 atëherë konstaton se të gjitha korrigjimet duhet të bëhen për periudhën 05/2015 deri në periudhën 09.01.2016 bazuar në shpenzimet e regjistruara në njehsorin e ri elektrik nr. 64647475 për periudhën 05/2016 deri në periudhën 01/2017 duke marrë për bazë vetëm shpenzimet e regjistruara në tarifën e lartë, pasi që kWh e faturuar në tarifën e ulët me njehsorin nr. 4692300 janë në rregull.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 24.09.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

#### **Bordi i ZRRE-së:**

---

Arsim Janova, u.d. kryesues

---

Besim Sejfiqaj, anëtar

---

Selman Hoti, anëtar

---

Izet Rushiti, anëtar

#### **Vendimi iu dërgohet:**

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit Ibrahim Bucaliu dhe
- Arkivit të ZRRE-së.